

“Bota të shpallë mbrojtësin e saj: Shën Dhimitri Mirovliiti në Ballkan”



Në kuadër të aktivitetit kulturor dhe shpirtëror “Bota të shpallë mbrojtësin e saj: Shën Dhimitri Mirovliiti në Ballkan”, Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Imzot Joani, përuroi stendën që përfaqëson Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe vendin tonë.

Ceremonia u zhvillua në prani të Presidentit të Republikës së Greqisë, z. Konstantin Tasoulas, Tërëshenjtërisë së Tij, Patriarkut Ekumenik, Bartolomeut, Fortlumturisë së Tij, Patrikut të Bullgarisë, Daniel, Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit të Qipros, Gjergji dhe Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit të Athinës dhe Gjithë Greqisë, Jeronimi. Ky moment i shënuar dëshmoi edhe njëherë unitetin e Kishave Orthodhokse dhe njëherësh përfaqësoi një rast të veçantë ku Kisha e Shqipërisë dha zërin e saj në mozaikun e përbashkët të traditës Orthodhokse botërore.

[Radio “Ngjallja”](#)